



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
MINISTRI

Nr. 2666/2 Prot.

Tiranë, më 28/05/2026

URDHËR

Nr. 126, datë 28/05 2026

PËR

“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT PËR MINISTRINË E
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË 2026-2029”

Në zbatim të pikës 4, nenit 102 të Kushtetutës, të vendimit nr.508, datë 25.9.2025 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”, vendimit nr.859, datë 26.12.2024 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2024-2030, Planit të Veprimit 2024-2026 në zbatim të saj dhe Pasaportës së Treguesve të Performancës”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Planit të Integritetit për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë 2026-2029.
2. Ky urdhër publikohet për njohje në faqen zyrtare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI



PLANI I INTEGRITETIT

PËR MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

2026-2029

Miratuar me Urdhër nr.126, datë 28.05.2026 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë

Grupi i Punës për hartimin e Planit të Integritetit në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë:

Z. Evis Mamaj, Kryetar

Z. Lirim Sulaj, Anëtar

Znj. Anisa Gjondedaj, Anëtar

Znj. Nertila Hajdëri, Anëtar

Znj. Eridiola Marini, anëtar

Znj. Vilma Davidhi, Anëtar

Znj. Emi Kola, Anëtar

SHKURTESA DHE AKRONIME

GPI	Grupi i Punës për Integritetin
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
SP	Sekretari i Përgjithshëm
AB	Auditi i Brendshëm
BNJ	Burime Njerëzore
PSV	Procedura Standarde Veprimi

TABELA E PËRMBAJTJES

1. Rëndësia e Planit të Integritetit.....	5
1.1 Procesi i hartimit të Planit të Integritetit.....	6
1.2 Qasja metodologjike	6
2. Qëllimet dhe objektivat e Planit të Integritetit	7
3. Plani i veprimit.....	9

1. Rëndësia e Planit të Integritetit

Plani i Integritetit kontribuon në forcimin dhe konsolidimin e administratës publike, e cila karakterizohet nga integriteti, transparenca dhe llogaridhënia e institucioneve publike.

Ministria e Infrastrukturës Energjisë (Ministria), është e ndërgjegjshme për sfidat në kuptimin e integritetit dhe llogaridhënies në sistemin e saj, si dhe është e angazhuar në këtë kuadër për përmirësimin dhe forcimin e parimeve të administratës publike. Për këtë arsye, Ministria ka zhvilluar dokumentin e Planit të Integritetit, i cili përmban çështjet e rëndësishme për sistemin e menaxhimit të integritetit të ministrisë.

Zhvillimi i mekanizmave të transparencës dhe llogaridhënies do të ndihmojnë në forcimin e llogaridhënies së Ministrisë, që është parakusht thelbësor për parandalimin e korrupsionit.

Ky Plan Integriteti synon të arrijë përmirësime të rëndësishme sistematike drejt qeverisjes së mirë në Ministri, konkretisht në:

- Përmirësimin e standardeve të aksesit në informacionin publik, i cili do të rrisë transparencën;
- Përmirësimin e akteve të brendshme rregullatore në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit, duke konsoliduar një administratë që karakterizohet nga etika dhe integriteti;
- Forcimin e mekanizmave të pjesëmarrjes qytetare, që do të rrisë besimin e publikut ndaj Ministrisë, si edhe rritjen e nivelit të pjesëmarrjes së publikut në aktivitetet e saj;
- Përmirësimin e mekanizmave të planifikimit, monitorimit dhe kontrollit të brendshëm financiar, e cila do të sigurojë efikasitet në menaxhimin e fondeve publike.

1.1 Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Plani i Integritetit, është rezultat i një analize gjithëpërfshirëse për identifikimin dhe vlerësimin e riskut të integritetit në Ministri, analizë e cila u krye gjatë periudhës Janar-Maj 2026. Procesi përfshiu vlerësimin sipas këtyre fushave të veprimtarisë së Ministrisë: (i) Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli i Brendshëm; (ii) Menaxhimi i Burimeve Njerëzore; (iii) Ruajtja dhe administrimi i dokumenteve zyrtare; (iv) Fusha e Politikave dhe Zhvillimit të Infrastrukturës dhe Territorit; (v) Fusha e Politikave dhe Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë; (vi) Fusha Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Infrastrukturë dhe Energji si dhe (vii) Fusha Ekonomike dhe e shërbimeve mbështetëse. Instrumenti metodologjik i përdorur është metodologjia për Vlerësimin e Riskut të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore. Ai u zbatua nga grupi i punës me punonjës të ministrisë.

Faza 1: Përgatitja, komunikimi dhe mobilizimi i burimeve njerëzore

Më qëllim zhvillimin e një Planit Integriteti është miratuar me urdhër të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 193 datë 24.12.2025 “Për ngritjen e Grupit të Punës për Hartimin e Planit të Integritetit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”, i ndryshuar, grupi i punës me 7 anëtarë. Grupi i punës komunikoi qëllimin dhe objektivat e Planit të Integritetit me punonjësit e Ministrisë për Planin e Integritetit dhe procesin e planifikimit të tij. Ky komunikim, ndihmoi grupin e punës për të marrë në konsideratë një larmi çështjesh në institucion.

Faza 2: Identifikimi dhe analizimi risqeve të integritetit

Grupi i punës shqyrtoi kornizën ligjore, rregullatore, strategjike, si dhe dokumente të ndryshme operative të Ministrisë. Gjithashtu, u analizuan të dhëna nga performanca, monitorimi dhe zbatimi i aspekteve të veçanta të integritetit në institucion vijoi me identifikimin dhe analizimin e risqeve të integritetit dhe faktorëve të tyre, për proceset e punës sipas fushave të veprimtarisë së ministrisë. Pjesë e kësaj analize ishin edhe të dhënat cilësore të mbledhura nga 16 grupet e fokusuara me punonjësit e drejtorive të ministrisë.

Në këtë fazë, grupi i punës analizoi të dhënat nga pyetësi për aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit. Punonjësit e administratës së ministrisë, plotësuan një pyetësor në mënyrë anonime, në formë elektronike, për të siguruar të dhëna dhe informacione për vlerësimin e sistemit të menaxhimit të integritetit. Anketimi u plotësua nga 75 punonjës të ministrisë.

Faza 3: Plani i masave për menaxhimin e integritetit dhe miratimi

Në kuadër të konsolidimit të një sistemi të menaxhimit të integritetit në institucion, Ministria disponon mekanizma për sigurimin e transparencës, llogaridhënies dhe integritetit. Për këtë arsye, grupi i punës, hartoi planin e veprimit për menaxhimin e risqeve të integritetit, i cili përfshiu masa të reja kontrolli apo përmirësimin e masave ekzistuese. Analiza e realizuar në fazën e mësipërme diktoi nevojën për të përmirësuar kuadrin rregullator të brendshëm dhe zhvillimin e burimeve njerëzore të ministrisë, përmes forcimit të njësisë së sinjalizuesve, konfliktit të interesit, etikës, aksesit në informacionin publik dhe konsultimin publik. Masat përshkruajnë aktivitetet që duhet të zbatohen për zvogëlimin apo eliminimin e risqeve të integritetit, afatet kohore dhe përgjegjësitë organizative për zbatimin e tyre.

1.2 Metodologjia

Grupi i punës, në procesin e zhvillimit të Planit të Integritetit, ka zbatuar dy metoda kryesore për të analizuar dhe vlerësuar cenueshmërinë e integritetit, metoda cilësore dhe ajo sasiore. Hapi i parë ka qenë zhvillimi i një sesiioni trajnues me grupin e punës dhe punonjësit e Ministrisë për metodologjinë e vlerësimit të integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore. Këtu përfshihet edhe analiza e kuadrit të brendshëm rregullator dhe strategjik të Ministrisë, e cila përfshin, urdhra, manuale, strategji apo dokumente politikash, rregullore dhe akte të brendshme. Në vijim është kryer analizimi i të dhënave nga grupet e diskutimit me stafin. Takimet e fokusuara shërbyen

për të identifikuar ngjarje me rrisht të mundshëm në realizimin e proceseve të punës, praktika pune dhe funksione të cilat janë të ekspozuara ndaj shkeljeve të mundshme etike dhe profesionale, apo parregullsi të tjera.

Metoda tjetër e përdorur ishte ajo sasiore, përmes vlerësimit me anë të pyetësorit të strukturuar që përfshinte pyetje mbi çështje të veçanta të integritetit dhe etikës në institucion. Pyetësi është një mjet i rëndësishëm për mbledhjen e të dhënave të sakta dhe të kuantifikuara të risqeve të integritetit, për aspekte të veçanta të integritetit në Ministri. Pyetësi i vlerësimit adreson nivelin e zbatimit të ligjit, procedurat e rekrutimit, vlerësimin e performancës, të mësuarit dhe zhvillimin, komunikimin e brendshëm, si dhe rolin e njësive të Ministrisë. Këtij pyetësi, punonjësit e ministrisë iu përgjigjën në mënyrë anonime. Anketimi përfshiu një kampion me 75 punonjësit Kampionimi përfshiu një shpërndarje të gjerë në lidhje me gjininë, moshën dhe vjetërsinë në punë. Të anketuarit meshkuj përbëjnë 33.3 % të kampionit krahasuar me punonjëset gra që janë 66.7 %.

Punonjësit e moshës 26-35 vjeç kanë përqindjen më të madhe në kampion me 32%. Edhe të intervistuarit në moshë 36-45 vjeç janë të përfaqësuar mirë dhe përbëjnë 29.3% të kampionit. Kategoria e grup-moshës 46-55 vjeç përfaqësojnë 20% të kampionit. Në përgjithësi, të anketuarit me më pak përvojë pune, (kategoria më pak se 5 vite punë), përbëjnë 28.% të kampionit, ku me të njëjtën përqindje janë edhe të anketuarit që kanë 5-10 vite.

2. Qëllimet dhe objektivat e Planit të Integritetit

Qëllimi kryesor i këtij Plani të Integritetit është përmirësimi i sistemit të llogaridhënies, dhe transparencës në Ministri, për të rritur besimin publik ndaj saj, si edhe për përmirësimin e mekanizmave kundër korrupsionit. Për arritjen e synimeve të mësipërme u identifikuan pesë objektiva:

- Përmirësimi i etikës dhe mekanizmave të integritetit dhe të luftës kundër korrupsionit;
 - Forcimi i kuadrit rregullator të integritetit dhe instrumenteve të luftës kundër korrupsionit
 - Instrumenta për rritjen e integritetit dhe luftën kundër korrupsionit në veprimtarite kryesore specifike të MIE që kanë të bëjnë me licensimet dhe me PPP.
 - Instrumenta për rritjen e integritetit dhe luftën kundër korrupsionit në menaxhimin e sistemit të informacionit në MIE
- Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore;
- Rritja e transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare;

Objektivat

2.1 Përmirësimi i etikës dhe mekanizmave të integritetit dhe të luftës kundër korrupsionit

Me qëllim përmirësimin dhe forcimin e mekanizmave të etikës dhe integritetit, Ministria do të punojë në:

- Përmirësimin e akteve të brendshme për aspekte të veçanta të lidhura me etikën dhe integritetin;
- Zhvillimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, bazuar në parimet e etikës dhe integritetit.

Respektimi rigoroz i normave etike nga punonjësit e administratës së Ministrisë është i rëndësishëm për krijimin e një mjedisi pune që parandalon sjelljen jo-etike dhe joprofesionale. Ministria do të vijojë të përmirësojë rregulloret dhe informojë punonjësit, me qëllim respektimin e normave të etikës dhe integritetit, të parashikuara nga legjislacioni për etikën në administratën publike në fuqi.

Rregulloret e brendshme të rishikuara të Ministrisë do të mbulojnë komunikimin zyrtar, paanshmërinë, disiplinën e punës dhe menaxhim efikas të burimeve publike. Ministria do të sigurojë që të respektohen parimet e etikës nga ana e saj dhe institucioneve të varësisë, në mënyrë që mekanizmat e menaxhimit të tyre të jenë në përputhje të plotë me kuadrin ligjor, përfshirë mbrojtjen e sinjalizuesve dhe Kodin e Etikës së institucionit.

Në arritjen e këtij objekti, Ministria do të zbatojë dy drejtime kryesore për parandalimin e korrupsionit dhe sjelljeve jo-etike të lidhura me integritetin:

Së pari, Ministria do të punojë në drejtim të forcimit të mekanizmave institucionalë, me qëllim minimizimin e risqeve të shkaktuara nga humbja e personelit të kualifikuar dhe ndryshimi i menaxhimit ose legjislacionit.

Së dyti, do të fokusohet në ndërgjegjësimin e punonjësve, ku përpos rritjes së kapaciteteve të stafit aktual të Ministrisë, do të trajtojë punonjësit e punësuar rishtazi mbi rregulloret që lidhen me etikën, integritetin dhe konfliktin e interesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Promovimi i mbrojtjes së sinjalizuesve është thelbësor për një administratë publike cilësore, të paanshme, efektive, që bazohet në parimet e integritetit dhe objektivitetit. Mbrojtja e sinjalizuesve është gjithashtu e rëndësishme si një mekanizëm efektiv i mbikëqyrjes publike. Ministria do të ndërgjegjësojë dhe do të informojë në mënyrë periodike punonjësit e saj mbi procedurat ligjore në lidhje me sinjalizuesin dhe mbrojtjen e tij, në mënyrë që sinjalizuesit ta kenë më të lehtë raportimin ligjor, shkeljet dhe sjelljet e tjera jo-etike.

Një komponent i rëndësishëm i qeverisjes së mirë në Ministri është edhe promovimi i planifikimit racional dhe monitorimi efektiv i aktiviteteve të saj, përfshi këtu programe dhe projekte në industri dhe energji, infrastrukturë dhe territor, mbështetur në analizën kosto-efektivitetit.

Duke qenë se projektet e infrastrukturës dhe territorit, si dhe ato të energjisë dhe industrisë, përbëjnë shumicën e projekteve, Ministria angazhohet në hartimin dhe zbatimin e metodologjive të monitorimit, të cilat do të kontribuojnë edhe në përmirësimin e planifikimit dhe monitorimit të projekteve infrastrukture.

Ministria është e vetëdijshme se ky dokument është një ndër instrumentet që demonstrojnë vullnetin dhe angazhimin e saj për të ngritur nivelin e integritetit institucional dhe mundësuar politika efikase në sektorët e sipërpërmedhur, transparencë dhe gjithpërfshirje dhe përgjatë hartimit, zbatimit dhe monitorimit të tyre.

2.1 Përmirësimi i Sistemit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

Në drejtim të përmirësimit të menaxhimit të burimeve njerëzore, Ministria angazhohet të vazhdojë të zbatojë me rigorozitet ligjin për shërbimin civil, i cili garanton një kuadër të sigurtë ligjor për krijimin e një shërbimi civil profesional dhe të qëndrueshëm. Përveç kësaj, do të

bëhen përpjekje për të forcuar një politikë të menaxhimit të burimeve njerëzore, e cila do të bazohet në parimet e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritave, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, si dhe garanton stabilitetin e nëpunësve civilë dhe vazhdimësinë e shërbimit civil.

Për këtë arsye, Ministria do të vijojë punojë drejt garantimit të një administrate të qëndrueshme dhe parandalimit të humbjes së personelit të kualifikuar, e cila synon të rrisë efikasitetin dhe do të forcojë mundësitë për zhvillim profesional.

2.2 Rritja e transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare

Me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë dhe integritetit, Ministria do të punojë drejt përmirësimit të mekanizmave të transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare, i cili do të rrisë besimin e publikut ndaj Ministrisë dhe do të sigurojë ofrimin e shërbimeve cilësore publike.

Duke konsideruar rëndësinë e aksesit në informacionin publik për krijimin e një administrate transparente, Ministria do të vijojë të punojë në drejtim të metodave proaktive në publikimin e informacionit publik.

Mekanizmat e pjesëmarrjes qytetare do të përmirësohen në Ministri nëpërmjet bashkëpunimit me ekspertë, përfaqësues të shoqërisë civile, organizata ndërkombëtare dhe shoqatat e biznesit, me qëllim përmirësimin e pjesëmarrjes së tyre në fusha të ndryshme të saj.

Ministria do të sigurojë pjesëmarrjen e publikut në procesin e identifikimit të prioritetëve të saj afatgjatë. Ministria do të forcojë mekanizmat e pjesëmarrjes për shoqërinë civile dhe grupe të veçanta të interesit gjatë zhvillimit dhe konsultimit të dokumenteve të politikave e strategjive apo ligjeve për fushën e saj të përgjegjësisë.

3 Plani i Veprimit


Plani i Veprimit, përfshin tërësinë e masave për të adresuar risqet dhe faktorët e risqeve të integritetit, të identifikuar sipas fushave të përgjegjësisë së Ministrisë. Ai përmban përshkrime për aktivitetet specifike që do të zbatohen për të arritur tre objektivat e Planit të Integritetit. Zbatimi i Planit të Integritetit, do të pasohet nga procesi i raportimit dhe monitorimit.

Raportimi është një procedurë e rregullt, që siguron zbatimin e Planit të Integritetit për risqet e integritetit sipas afateve kohore të parashikuara. Ky proces ndiqet nga personi përgjegjës, i caktuar nga titullari i institucionit, i cili është përgjegjës për të ndjekur progresin e zbatimit.

Frekuenca minimale e raportimit është brenda një periudhe gjashtëmujore.

Monitorimi i Planit të Integritetit është periodik (çdo vit) dhe pasqyron kryerjen e aktiviteteve nga ana e punonjësve/grupeve të punonjësve përgjegjës për zbatimin e masave të miratuara në të. Monitorimi do të përcaktojë nëse këto masa të zbatuara kanë qenë efikase, nëse kanë nxjerrë në pah ndryshime të kontekstit të institucionit apo ndryshime të vetë risqeve, të cilat mund të kërkojnë rishikimin e tij. Pas monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit, Ministria do të rishikojë dokumentin dhe do ta përditësojë atë me sfidat e ardhshme. Ministria do të publikojë gjithashtu një raport për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit.

Fig. 1. Monitorimi i Planit të Veprimit



PLANI I VEPRIMIT PËR INTEGRITETIN

PËR MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

2026 - 2029

OBJEKTIVI 1: PËRMIRËSIMI I ETIKËS DHE MEKANIZMAVE TË INTEGRITETIT DHE TË LUFTËS KUNDËR KORRUPSIONIT

1.1 Forcimi i kuadrit rregullator të integritetit dhe instrumenteve të luftës kundër korrupsionit

Fusha e kuadrit rregullator të integritetit dhe instrumenteve të luftës kundër korrupsionit						
Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut (Burimi i rrezikut/ Tipi i impaktit)	Rreziku Inherent	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatim	Struktura Përgjegjëse	Afati I zbatimit e aktiviteve
1	Kuadri rregullator për integritetin (Kodi i etikës).	Përputhshmërie dhe Reputacional	Mesatar	- Vlerësimin periodik të opinionit të stafit për nivelin e njohjes dhe zbatimit të Kodit të Etikës. - Planifikimi dhe ofrimi i trajnimeve specifike periodike vjetore për etikën.	Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (ASPA)	2026- 2027-2028 -2029

2	Konflikti i interesit dhe përditësimi i regjistrit të konfliktit të interesit	Përputhshmërie dhe Reputacional	Mesatar	1. Përditësimi i regjistrit të konfliktit të interesit. 2. Planifikimi dhe ofrimi i trajnimeve specifike periodike vjetore për konfliktin e interesave. 3. Të informohet stafi me përditësimet e kuadrit ligjor të konfliktit të interesit në fuqi.	Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore	2027-2028-2029
3	Kuadri rregullator i brendshëm. Mungesa e planeve të punës të standartizuara sipas ndryshime ligjore dhe nënligjore dhe të miratuara nga titullari.		Mesatar	Përditësimi i kuadrit të brendshëm rregullator dhe hartimi i formatit të planeve vjetore të punës.	Grup pune me punonjës të ministrisë për hartimin e këtyre model planeve	Gjashtë mujori i dytë 2026.
4	Kuadri rregullator mbi mekanizmat e brendshëm për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.	Përputhshmërie dhe Reputacional	Mesatar	Të realizohet një plan trajnimi/takimesh informuese dhe ndërgjegjësuere për punonjësit e MIE-s mbi përditësimin e ndryshimeve të kuadrit rregullator për mbrojtjen e sinjalizuesve, rolit të njësive përgjegjëse, si dhe mbi parashikimet e ruajtjes së konfidencialitetit dhe mbrojtjes ndaj hakmarrjes.	Njësia Përgjegjëse për mbrojtjen e sinjalizuesve + BNJ	Gjashtëmujori i dytë 2026 e në vazhdim

5	Dokumentimi i vlerësimit të performancës së çdo drejtorie dhe analizës vjetore të veprimtarisë së MIE.	Operacional	Mesatar	Të miratohet modeli i analizës vjetore për çdo drejtori dhe modeli institucional .	Grup Pune Të gjithë Drejtoritë	Brenda Gjashtëmujorit të parë 2027
6	Mungesa e regjistrimit të dhuratave	Operacional	Mesatar	Krijimi i regjistrimit të dhuratave për institucionin, njoftimi i stafit dhe përditësimi i tij.	Drejtoria e Burimeve Njerëzore	Gjashtëmujori i II-të 2026 e në vazhdim
7	Konflikti i interesit. Vlerësimi i kuadrit rregullator të proceseve në veprimtarinë e derregullimit dhe licencave dhe dokumentimi i atyre që lind nevoja e aplikimit të mekanizmave të konfliktit të interesit.	Operacional	Mesatar	Miratimi i deklartës tip të konfliktit të interesit për procese e veprimtarisë në fushën e derregullimit dhe licencave. Përcjellja e këtij dokumenti për njohje të gjithë punonjësve që mbulojnë veprimtarinë e derregullimit dhe licensave në MIE.	Grup Pune	Gjashtëmujori dytë 2026

8	Aktet e integritetit dhe antikorruptionit dhe informimimi ndaj funksionarëve politikë (anëtarët e kabinetit të ministrit)	Operacional	Mesatar	1. Krijimi i një pakete së akteve ligjore dhe nënligjore për integritetin dhe antikorruptionit. 2. Shpërndarja me qëllim informimimi e kësaj pakete në format online. 3. Trajnime periodike si për punojësit e pranuar në shërbimin civil ashtu dhe anëtarët e kabinetit të ministrit (këshilltarët).	Drejtoria e Burimeve Njerëzore	2027-2028-2029
9	Akte rregullative. Mungesë e rregullave të organizimit dhe funksionimit të Sekretariatit Teknik pranë Komisionit të Licensimit.	Burimet Njerëzore/ Reputacional dhe Imazhi	Lartë	Miratimi i një rregulloreje të brendshme për funksionimin e Sekretariatit Teknik pranë Komisionit të Licensimit në ministri.	Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licensave dhe Monitorimit/ Gjashtëmujori i parë 2027	6-mujori i parë 2027

1.2 Instrumenta për rritjen e integritetit dhe luftën kundër korupsionit në veprimtarite kryesore specifike të MIE që kanë të bëjnë me licensimet dhe me PPP.

Fusha e Menaxhimit të veprimtarive kryesore specifike						
Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut (Burimi i rrezikut/ Tipi i impaktit)	Rreziku Inherent	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatim	Struktura Përgjegjëse	Afati I zbatimit e aktiviteve
10	Trajtimin e ankesave për procedurat konkurruese për PPP	Operacional	Mesatar	Në kuadër të hartimit dhe miratimit të PSV të brendshme në MIE të përfshihet dhe trajtimi i ankesave për procedurat konkurruese për procesin e prokurimeve apo PPP.	Drejtoria e Partneritetit Publik Privat në Fushën e Infrastrukturës dhe Energjisë	Gjashtë muji i parë 2028 dhe në vazhdim
11	Planit vjetor minerar (në zbatim të nenit 6 të ligjit nr. 1034/2010).	Operacional	Mesatar	1. Miratimi i Planit Vjetor minerar. 2. Publikimi i Planit në faqen e internetit të ministrisë dhe pasqyrimi në hartën minerare dixhitale.	Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Minerave dhe Industrisë + Koordinatori për të Drejtën për Informim	Gjashtëmuji i dytë 2026

12	Leje- licenca në veprimtarinë minera. Vonesa në procesin marrjes së lejeve mjedisore nga Ministria e Mjedisit para miratimit të sipërfaqes për aktivitet mineral.	Operacional	I lartë	Vlerësimi i mekanizmave për bashkëpunimin me Ministrinë e Mjedisit për eliminimin e vonesave në procesin e: - dhënies së lejeve/licensave mjedisore të cilat janë pjesë e dokumentaceve për dhenien e lejeve për aktivitet mineral. - heqjes nga fondi pyjor i sipërfaqeve të miratuara për zhvillimin e aktivitetit mineral.	Sek. Përgj. + Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në fushën e Minierave dhe Industrisë + Ministria e Mjedisit	Gjashtëmujori i dytë 2028
13	Lëshimi i autorizimeve për qendrën teknike të Tahogرافit.	Operacional	Mesatar	1. Ngritje e një grupi për inspektimin në terren të plotësimit të kushteve për lëshimin e autorizimeve. 2. Përgatitja e një raporti për procesin inspektimit të qendrës teknike të Tahogرافit dhe paraqitja e tij drejtorisë dhe SP-së.	Grup pune me punonjës të ministrisë i koordinuar nga Drejtoria e Derregullimit, lejeve dhe Licensave – Sektori i Monitorimit të Transporteve.	Gjashtëmujori i dytë 2027

14	Mungesa e planeve vjetore të miratuara për monitorim të aktiviteteve të OEN/OMVK dhe rakordimi me drejtoritë e tjera të ministrisë për ngritjen e grupeve të monitorimit.	Operacional	Mesatar	1. Hartimi dhe miratimi i planeve vjetore për monitorim të aktiviteteve të OEN/OMVK nëpërmjet rakordimit me drejtoritë e tjera të ministrisë për ngritjen e grupeve të monitorimit. 2. Përcaktimi i këtij detyrimi në Rrregulloren e Brendshme të Ministrisë. 3. Publikimi i raporteve të monitorimit të aktivitetit të OEN/OMVK-ve në faqen zyrtare të ministrisë.	Drejtoria e Derregullimit, lejeve dhe Licensave	Gjashtë mujori i I-rë 2027
----	---	-------------	---------	--	---	----------------------------

1.3 Instrumenta për rritjen e integritetit dhe luftën kunder korupsionit në menaxhimin e sistemit të informacionit në MIE

Fusha e Menaxhimit të sistemit të informacionit						
Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut (Burimi i rrezikut/ Tipi i impaktit)	Rreziku Inherent	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatim	Struktura Përgjegjëse	Afati I zbatimit e aktiviteteve
15	Akresi në informacion në arkiven e MIE. (Mungesë kushtesh optimale të ruajtjes)	Operacional	Mesatar	Vlerësimi i mundësisë për përmirësimin e kushteve teknike të ambienteve të arkivës.	DPSHM	Grup Pune (Gjashtëmujori i parë 2027- e në vazhdim)

16	Akses në informacion (mungesë dhe nevojë rinovimit të mjeteve për kalimin e dokumentacionit shkresor në elektronik)	Operacional	Mesatar	Identifikimi i nevojave dhe marrja e masave për sigurimin e pajisjeve të nevojshme cilësore si skanera etj, për kalimin e dokumentacionit shkreson në sistemin elektronik.	DPSHM	(Gjashtëmujori i parë 2027)
17	Akses në Informacion. Procedurat e menaxhimit të kalimit të sistemit shkresor në atë elektronik.	Operacional	Mesatar	Hartimi i një rregulloreje të brendshme për administrimin e dokumentacionit shkresor dhe kalimin e tij në Sistemin përkatës EDRMS.	DPSHM	

OBJEKTIVI 2: PËRMIRËSIMI I SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Fusha e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore						
Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut (Burimi i rrezikut/ Tipi i impaktit)	Rreziku Inherent	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatim	Struktura Përgjegjëse	Afati I zbatimit e aktiviteve
1	Përditësimi dhe unifikimi i Paketës së PSV për çdo proces kyesorë të veprimtarisë së MIE dhe gjurma e auditimit për këto procese.	Operacional	Lartë	1. Caktimi për çdo drejtori i një punonjësi që do të mbikëqyr procesin. 2. Trajnimi i këtyre punonjësve për këtë proces (për MFK). 3. Të unifikohet hartimi i PSV për të proces kyesorë të veprimtarisë së çdo drejtorie si dhe të hartohet gjurma e auditimit për çdo proces pune	1.Të gjithë Drejtoret. 2.BNJ në bashkëpunim me ASPA. 3.Të gjitha drejtoritë	6-mujori 2 2026
2	Përditësimi dhe unifikimi i iërshkrimit të punës i çdo pozicioni pune të punonjësve me procedurat PSV me proceset e punës së çdo drejtorie.	Reputacional dhe Operacional	Lartë	Të përditësohet përshkrimi i punës i çdo pozicioni pune të punonjësve me procedurat PSV për proceset e punës së çdo drejtorie.	Të gjitha drejtoritë në bashkëpunim me BNJ	6-mujori 2 2026

3	Dokumentimi i ngarkesës së punës së punonjëse të anagazhuar në detyra të veçanta në zbatim të Agjendës Kombëtare të Reformave 2024-2027	Operacional	Mesatar	Strukturat që janë të angazhuara me Instrumentin e Faciliteti RGF të dokumentojnë ngarkesën e punës për këtë instrument në raport me gjithë punën në përshkrimin e punës të punonjësit.	Struktura e anagazhuar me Instrumentit Facilitetit RGF (Urdhëri i Ministrit të MIE nr. 96, datë 01.07.2025.	6-mujori 2 2026
4	Paketa ligjore dhe nënligjore e çdo fushe të veprimtarisë së MIE.	Operacional	Mesatar	1. Pregatitje e paketës informative e akteve ligjore dhe nënligjore për çdo fushë të veprimtarisë së MIE. 2. Shpërndarje e paketës informative tek punonjësit e rinj të pranuar në MIE.	Të gjitha drejtoritë	2027 2028 2029
5	Informimi i Stafit Politik	Operacional	Mesatar	1. Njoftim i paketës informative tek anëtarët e kabinetit të ministrit (këshilltarë politikë). 2. Trajnime periodike për etikën dhe antikorrupsionin për anëtarët e kabinetit. 3. Kryerja e një trajnimi fillestar në fillimet e marrjes së detyrës nga anëtarët e kabinetit.	BNJ	2027 2028 2029
6	Dokumentimi i angazhimit të këshilltarëve politikë.	Operacional	Mesatar	Përditësimit i angazhimit të këshilltarëve politikë.	BNJ	2027 2028 2029

7	Masat për mbulimin e proceseve që u përkasin vendeve vakante të punës	Operacional	Mesatar	Përditësimi i përshkrimeve të punës së punonjësve të cilët mbulojnë punën dhe proceset e vendeve vakante të punës.	Të gjitha drejtoritë & BNJ	2027 2028 2029
8	Plani i trajnimeve për kualifikimin personal të stafit në fushat specifike të veprimtarisë së MIE	Operacional	Mesatar	Vlerësimi i nevojave për training dhe hartimi i një plani training për stafin e Ministrisë në bashkëpunim me ASPA, Institucionet e Specializuara apo jashtë vendit për detyra specifike të fushës së veprimtarisë së MIE.	Të gjitha drejtoritë BNJ & ASPA	2027 2028 2029
9	Trajnime për etikën dhe korrupsionin stafit të MIE	Reputacional dhe Operacional	Mesatar	Informim i rregullt për etikën dhe instrumentet e luftës kundër korrupsionit, të drejtën e informimit përfshirë edhe për mbrojtjen e të dhënave personale.	BNJ Njësia Përgjegjëse për Sinjalizimin Etj.	2027 2028 2029
10	Plotësimi i vendeve vakante në Organikën e MIE	Operacional	Lartë	Të vlerësohen bashkëpunim me instancat kompetente për të vënë në lëvizje mekanizmat e plotësimit të Strukturës nga ana e DAP.	DPSHM	2026 2027
11	Promovimi në detyrë i punonjësve	Operacional	Mesatar	Informim i rregullt i stafit të MIE për raste të vendeve vakante me qëllim promovimin në detyrë të punonjësve.	BNJ	2026 2027 2028 2029

OBJEKTIVI III: RRRITJA E TRANSPARENCËS DHE PJESËMARRJES QYTETARE

Fusha e transparencës dhe llogaridhënies						
Nr.	Risku dhe ngjarjet e mundshme	Kategoria e faktorëve të riskut (Burimi i rrezikut/ Tipi i impaktit)	Rreziku Inherent	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatim	Struktura Përgjegjëse	Afati I zbatimit e aktiviteve
1	Përditësimi me ndryshimet strukturore i dokumentimit të linjave të bashkëpunimit, raportimit, afateve dhe përgjegjësisve brenda MIE-së, për vlerësimin dhe kthimin e përgjigje kërkesave për informim.	Operacional/ Reputacioni	I lartë	Parashikimi në PSV/Manual procedurash i linjave të komunikimit të koordinatorit me strukturat e MIE-së, afatet dhe mekanizmat për identifikimin e përgjegjësisve për moszbatimin e detyrimeve ligjore mbi dhënien e informacionit me kërkesë.	Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator	Gjashtëmuji i parë 2027
2	Instrumentet për përmirësim e transparencës së MIE	Reputacional	Mesatar	Publikim i vazhdueshëm i informacionit zyrtar, sipas Ligjit për të Drejtën e Informimit.	Të gjitha drejtoritë	2026- 2027- 2028- 2029

3	Përditësimi i Programit të Transparencës	Reputacional	Mesatar	Monitorimi periodik dhe të përditësohet rregullisht Programi i Transparencës.	Koordinatori i Drejtës së Informimit	2026- 2027-2028- 2029
4	Publikimi i angazhimit të këshilltarëve politikë	Reputacional	Mesatar	Përditësimi i publikimit të kontakteve dhe të anagazhimit të këshilltarëve politik.	BNJ	2026- 2027-2028- 2029
5	Krijimi i një linku ku të publikohet lista e kontratave koncensionare të nënshkruara nga MIE.	Operacional	Mesatar	Publikimi i listës se kontratave koncensionare të nënshkruara nga MIE.	Drejtoria e Partneritetit Publik Privat ne Fushen e Infrastrukturës dhe Energjisë + Koordinatori për të Drejtën për Informim	Gjashtë mujori i dytë 2026 dhe në vazhdim
6	Paketa e marrëveshjeve ku MIE është palë.	Operacional	Mesatar	Krijimit dhe përditësimi i një baze të dhënash për marrëveshje, memorandume bashkëpunimi etj, që ka lidhur MIE. Publikimi i saj në faqen ëeb.	Drejtoria e Integritit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës	Gjashtëmujori i dytë 2027

7	Menaxhim i regjistrave on-line për licensat profesionale individuale për studim, projektim, për mbikëqyrje e kolaudim etj.	Operacional	Mesatar	Përditësimi periodik i regjistrave për licensat profesionale individuale lejet e akorduara për studim, projektim, për mbikëqyrje e kolaudim etj.	Sektori i monitorimit të lejeve në ndërtim + Koordinatori për të Drejtën për Informim	Gjashtëmujori i dytë 2028
8	Plani i Menaxhimit të masave të Reformës së Kontektivitetit, në kuadër të Axhendës së Ndërlidhjes.	Operacional/ Reputacioni dhe Imazhi	Mesatar	Publikimi në faqen zyrtare të ministrisë i Planit të Menaxhimit të Masave të Reformës së Konektivitetit.	Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Infrastrukturës dhe Transportit + Koordinatori për të Drejtën për Informim	Gjashtëmujori i dytë 2026

GRUPI I PUNËS PËR INTEGRITETIN